



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 09, datë 16.03.2022


PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RESTAURIMI I KULLËS SË KONTROLLIT DHE NDËRTESESË ATC,
NDËRTIMI I OBJEKTEVE: STACION ZJARRFIKËS, KOMPLEKSI I DEPOVE TË
MUNICIONIT, DEPOZITA KARBURANTI DHE PERIMETRI I SIGURISË,
NË BAZËN AJRORE KUÇOVË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË KUÇOVË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Repartit Ushtarak 3001, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Restaurimi i Kullës së Kontrollit dhe Ndërtesës ATC, ndërtimi i objekteve: Stacion zjarrfikës, kompleksi i depove të municionit, depozita karburanti dhe perimetri i sigurisë, në Bazën Ajrore Kuçovë”, me vendndodhje në Bashkinë Kuçovë, me zhvillues Komanda e Forcës Ajrore (Reparti Ushtarak Nr.3001).
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kuçovë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I MBROJTJES

NIKO PELESHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

